



Periodik mujor

Nr. 178

Mars 2024

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

Tregu i Sigurimeve, Janar-Shkurt 2024

VËSHTRIM MBI TREGJET

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

4 - 10

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

11-13

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar –Shkurt 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar - shkurt 2024 kapën vlerën 3,565 milionë lekë, ose 8.14% më shumë se në janar - shkurt 2023. Gjatë muajve janar - shkurt 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 204,626 me një rritje prej 9.41% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.28% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës sollën 8.72% dhe risigurimi me 0.003%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.64% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.36% të totalit të tregut.

Gjatë muajve janar - shkurt 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,286 milionë lekë, ose 19.03% më shumë se në periudhën janar - shkurt 2023.


Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar - shkurt 2024 kapën vlerën 815 milionë

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Shkurt 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-shkurt 2024 arritën rreth 2,045 milionë lekë, ose 9.76% më shumë se në periudhën janar - shkurt 2023.

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren bazuar në ligjin “Për Fondet e Pensionit Privat”



Faqe Kryesore ▶ Legjislati ▶ Projektakte ▶ Projektregullore "Për përcaktimin e penalteteve të zbatuara në rastin e tërheqjes

Projektregullore "Për përcaktimin e penalteteve të zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit privat"

 Materiali i plotë

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projektregulloren:

“Për përcaktimin e penalteteve të zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit privat”.

Kjo projektregullorje publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm:

[“Për përcaktimin e penalteteve të zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit privat”](https://amf.gov.al/projekt.asp?id=101)

Informacioni i plotë:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=101>



Mbikëqyrja e sigurimeve dhe pensioneve për një shoqëri më elastike (Insurance and Pensions Supervision for a more Resilient Society)

*Fjala e Petra Hielkema, Kryetare e EIOPA-s,
në forumin CRO në Venecia, Itali - 21 Mars 2024*

Marrë me shkurtime dhe redaktime

EIOPA është një organ i pavarur këshillues për Komisionin Evropian dhe Parlamentin Evropian në funksion të mbikëqyrjes së sigurimeve dhe pensioneve profesionale në BE.

EIOPA është një nga agjencitë e BE-së që kryen detyra specifike ligjore, teknike ose shkencore dhe këshillon bazuar në evidence, duke ndihmuar në formimin e politikave dhe ligjeve të mirëinformuara si në nivel kombëtar ashtu edhe për BE.

EIOPA mirëpret mundësitë për t'u angazhuar dhe për të diskutuar sfidat brenda industrisë së sigurimeve. Ne po përballemi këto kohë edhe me pyetje të rëndësishme shoqërore:

- Si mund të sigurohemi që katastrofat natyrore të mbeten ngjarje të sigurueshme edhe në të ardhmen?
- Çfarë mund të bëjmë në mënyrë që, ndërsa popullsia e Evropës plakët, qytetarët të mund të mbështeten në të ardhura dinjitoze pas daljes në pension?
- Si mund të promovojmë konkurrencën evropiane duke mbrojtur në mënyrë të barabartë qytetarët, pa marrë parasysh se në cilën vend të BE-së ata jetojnë apo blejnë sigurime?
- Dhe së fundi, çfarë duhet të kemi parasysh për të menaxhuar me përgjegjësi Inteligjencën Artificiale, AI dhe teknologjitë në zhvillim për një përfitim të barabartë për të gjithë?

E vërteta është se këto sfida mjedisore, ekonomike dhe teknologjike që shtrojnë përpara nesh këto pyetje kanë ndikime në elasticitetin/qëndrueshmërinë shoqërore. Ato paraqesin rreziqe të mundshme sistemike që mund t'i bëjnë shoqëritë tona më të cenueshme. Adresimi i tyre për të ndërtuar qëndrueshmëri shoqërore kërkon një qasje të koordinuar, gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrjen e përkushtuar të të gjithë aktorëve përkatës.

EIOPA po punon në këto fusha, që nga përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, tek adresimi i boshllëqeve të sistemeve të pensioneve, përmirësimi i biznesit ndërkufitar dhe së fundi, për të përfituar sa më shumë nga Inteligjenca Artificiale, duke mbrojtur qytetarët evropianë.

Vijon ...

...vijion

Pjesa e parë: Nat Cat

Më lejoni të filloj me hendekun e mbrojtjes ndaj katastrofave natyrore.

Humbjet nga katastrofat natyrore në BE, që prej vitit 1980 vlerësohen në mbi 650 miliardë euro dhe shumica dërrmuese e tyre, rreth 75%, mbeten të pasiguruar. Ishte një kohë kur këto shifra nuk provokonin të njëjtën ndjenjë urgjence si sot. Tashmë është e mirëpranuar nga qytetarët, politikëbërësit dhe industria, që efektet e ndryshimeve klimatike përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm për ekonominë, stabilitetin financiar dhe çojnë në përjashtim.

Për më tepër, kostoja në rritje e katastrofave natyrore vë në pikëpyetje rolin themelor të sektorit të sigurimeve si menaxher i rrezikut të shoqërive tona: Çfarë ndodh kur disa rreziqe bëhen shumë të kushtueshme për t'u siguruar? Kush duhet dhe kush mund të mbajë mbi supe shkallën në rritje të ngjarjeve të tilla?

Kjo nuk është një pyetje filozofike, por më tepër një thirrje për veprim për të minimizuar gjasat e këtij skenari, si duke zbutur ndryshimet klimatike për të zvogëluar ashpërsinë e katastrofave natyrore, por edhe duke zbatuar strategji për zbutjen e rrezikut, për të zvogëluar ndikimin, kur ato ndodhin.

Kjo është arsyeja pse aktivitetet e EIOPA-s në ndryshimet klimatike fillojnë me përmirësimin e të kuptuarit të hendekut të mbrojtjes në sigurime, duke u fokusuar në masat parandaluese dhe duke adresuar kërkesën e ulët për sigurimin nga fatkeqësitë natyrore NatCat.

Në bashkëpunim me Bankën Qendrore Evropiane, ne po shqyrtojmë gjithashtu opsionet e politikave se si të sigurojmë më mirë familjet dhe bizneset e BE-së kundër katastrofave natyrore të lidhura me klimën. Vitin e kaluar ne botuam një dokument të përbashkët diskutimi në të cilin propozojmë opsione politikash që synojnë rritjen e marrjes dhe efikasitetit të sigurimit të katastrofave klimatike, duke krijuar stimuj për t'u përshtatur dhe për të zvogëluar rreziqet klimatike.

Ne punojmë për një zgjidhje gjithëpërfshirëse për të zgjeruar mbulimin me katër shtylla. Këto janë:

1. Politikat e hartuara me masa të përshtatshme dhe zbutëse;
2. Obligacionet e katastrofës;
3. Partneritetet publik-privat në nivel kombëtar;
4. Partneritete në nivel të BE-së për të mbuluar humbjet të cilat mund të jetë e vështirë të sigurohen, nëse mbështetemi vetëm në zgjidhjet e bazuara në mekanizmat e tregut.

Vijon ...

Informacioni i plotë:

https://www.eiopa.europa.eu/in-surance-and-pensions-supervision-more-resilient-society-2024-03-21_en

...vijon

Është e qartë se, në mënyrë që rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike të vijojnë të mbeten të siguroshme edhe në të ardhmen, si konsumatorët ashtu edhe shoqëritë e sigurimit duhet të kontribuojnë në përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Dispozitat e sigurimit të krijuara posaçërisht për të inkurajuar konsumatorët të reduktojnë cenueshmërinë e tyre ndaj rreziqeve të lidhura me klimën, do të ndihmojnë. Kjo mund të nënkuptojë p.sh. çmimin e bazuar në rrezik. Dhe siguruesit kanë të dhënat, ekspertizën dhe kapacitetin e vlerësimit të rrezikut për ta bërë këtë. Nga ana tjetër, konsumatorët do të kenë një nxitje për të bërë atë që varet nga ata.

Një pjesë tjetër e zgjidhjes përfshin përdorimin e instrumenteve të tregut të kapitalit si obligacionet e katastrofës. Këto u ofrojnë siguruesve dhe risiguruesve privatë një mënyrë për të transferuar një pjesë të rrezikut që lidhet me politikat e nënshkrimit në tregjet e kapitalit.

Informacioni i plotë:

https://www.eiopa.europa.eu/in-surance-and-pensions-supervision-more-resilient-society-2024-03-21_en


Ne gjithashtu duhet të forcojmë partneritetet publik-privat në nivel kombëtar pasi këto mund të kontribuojnë gjithashtu në një elasticitet më të madh të sektorit të sigurimeve. Ata mund të mbështesin tregun e sigurimeve duke ofruar mbulim shtesë ose nëpërmjet sigurimit të drejtpërdrejtë ose duke zhdëmtuar një (ri)sigurues privat ndaj ngjarjeve të jashtëzakonshme. E njëjta gjë vlen edhe për partneritetet në nivel të BE-së.

Pra, kjo është qasja me katër shkallë. Por më lejoni të them edhe disa fjalë në veçanti për partneritetin publik-privat. Për një model të suksesshëm të PPP-ve, të gjithë kanë rol për të luajtur: qytetarët, siguruesit, qeveritë dhe sigurisht mbikëqyrësit. Baza për PPP-të e shëndosha është e rrënjësuar në hapin e parë të shkallës, zbutja dhe përshtatja e rrezikut - me qytetarët që mbrojnë veten duke bërë atë që është në fuqinë e tyre për të zvogëluar ekspozimin e tyre ndaj katastrofave natyrore.

Këtu kanë rol qeveritë kombëtare. Ky rol është të komunikojnë qartë me qytetarët se ku mund dhe nuk mund të ndërhyjnë autoritetet publike. Verën e kaluar EIOPA shqyrtoi sjelljen e konsumatorëve që ndikon në anën e kërkesës së sigurimit të NatCat. Zbuluam se një nga arsyt kryesore që njerëzit nuk marrin sigurimin e katastrofave natyrore është besimi i tyre se qeveria e tyre do të ndërhyjë, do të ndërhyjë në një masë shumë më të madhe se sa mundet në të vërtetë. Pra, është e rëndësishme të kundërshtosh këtë perceptim të rremë me informacion të sinqertë, të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar.

Vijon ...

...vijon



Së fundi, ka vend për një bashkëpunim më të madh midis industrisë dhe qeverive vendore, për shembull, që këshillat e qytetit të angazhohen me siguresit dhe të përdorin ekspertizën e tyre për të vlerësuar plotësisht rreziqet e mundshme NatCat përpara se të marrin vendime për zhvillimet e reja. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për zhvillimin elastik urban. Pikërisht në këtë kontekst EIOPA është e lumtur që iu kërkua të bashkohet me “*Climate Resilience Dialogue*” Dialogun e Rezistencës Klimatike, krijuar nga Komisioni Evropian. Qëllimi i Dialogut është të krijojë një forum diskutimi që do të forcojë mirëkuptimin kolektiv të siguresve, risiguresve, bizneseve, konsumatorëve, mbikëqyrësve dhe palëve të tjera të interesuara për hendekun e mbrojtjes ndaj faktorëve klimatikë.

Informacioni i plotë:

https://www.eiopa.europa.eu/in-surance-and-pensions-supervision-more-resilient-society-2024-03-21_en

EIOPA po vazhdon të punojë me Bankën Qendrore Evropiane për të promovuar më tej opsionet e politikave të dizajnuara për të rritur sigurimin ndaj katastrofave klimatike, duke krijuar njëkohësisht stimuj për njerëzit që të përshtaten dhe të reduktojnë rreziqet klimatike. Aktualisht ne po shikojmë partneritetet publiko-private që ekzistojnë në nivel kombëtar, si brenda dhe jashtë BE-së, për të nxjerrë mësim që janë të rëndësishme për tregun e BE-së.


Vendimet se si të bëhet sigurimi i disponueshëm dhe më i përballueshëm janë gjithashtu politike. Kjo vlen edhe për krijimin e PPP-ve në nivel kombëtar. Vullneti politik duhet të vijë nga qeveritë kombëtare. Dhe kur të ndodhë, EIOPA është aty për të mbështetur shtysën politike me vlerësime faktike. Ne mund ta përforcojmë debatin me gjetje të shëndosha teknike dhe duke shkëmbyer njohuri në mënyrë që PPP të mund të krijohen me sukses.

Në punën tonë më të fundit me Bankën Qendrore Evropiane, ne kemi shqyrtuar dhe vlerësuar 12 skema kombëtare të mbështetjes ndaj katastrofave natyrore me shkallë të ndryshme të përfshirjes së sektorit publik. Ne po studiojmë karakteristikat e tyre kryesore. Ne po pyesim se cilat janë objektivat e tyre strategjike, qëllimi i tyre, formati i tyre? Si i menaxhojnë ata rreziqet? Dhe cilat strategji financimi qëndrojnë në themel të tyre?

Përfundimet e marra nga kjo analizë do të shërbejnë gjithashtu si bazë për diskutimet e ardhshme me sektorin e sigurimeve dhe me politikëbërësit.

Vijon në numrin e radhës

IAIS - Konsultim publik mbi udhërrëfyesin për mbikëqyrjen e rrezikut klimatik, udhëzime dhe materiale mbështetëse të Parimeve Bazë në Sigurim, ICP



Public consultation on climate risk supervisory guidance – ICP guidance and supporting material

Ndryshimi i klimës është një temë kryesore strategjike për IAIS pasi është burim rreziku financiar, i cili ndikon në qëndrueshmërinë e siguruesve individualë dhe mund të çojë në rrezikun e stabilitetit financiar.

Një përgjigje adekuate nga mbikëqyrësit ndaj rreziqeve të lidhura me klimën do të mbështesë objektivat e mbikëqyrjes së sigurimit për mbrojtjen e mbajtësve të policave, duke kontribuar në stabilitetin financiar dhe duke promovuar ruajtjen e një tregu të drejtë, të sigurt dhe të qëndrueshëm të sigurimeve.

Për të promovuar një qasje të qëndrueshme dhe për të adresuar çdo boshllëk në kuadrin e mbikëqyrjes në sigurime, IAIS po kryen një seri prej katër konsultimesh publike mbi ndryshimet e propozuara në Parimet Themelore në Sigurime, ICP, dhe mbi materialin e ri mbështetës për të përfshirë më mirë rrezikun klimatik.

IAIS kreu konsultimet e para dhe të dyta në vitin 2023, tani ka iniciuar të tretin dhe do të nisë konsultimin e katërt e të fundit në muajt e fundit të vitit 2024. Ky konsultim i katërt do të mbulojë çështje si raportimin mbikëqyrës dhe prezantimet publike.

IAIS do t'i përgjigjet në mënyrë gjithëpërfshirëse komenteve të çdo konsultimi në fund të projektit.

Vijon ...

Informacioni i plotë:

<https://www.iaisweb.org/2024/03/public-consultation-on-climate-risk-supervisory-guidance-icp-guidance-and-supporting-material/>

IAIS - Konsultim publik mbi udhërrëfytesin për mbikëqyrjen e rrezikut klimatik, udhëzime dhe materiale mbështetëse të Parimeve Bazë në Sigurim, ICP



—○○○—
Ndryshimet e propozuara në materiale pasqyrohen në dokumentet e mëposhtme:

<https://www.iaisweb.org/uploads/2024/03/Climate-Risk-Consultation-Package-3-ICP-Guidance-Material.pdf>

<https://www.iaisweb.org/uploads/2024/03/Climate-Risk-Consultation-Package-3-Supporting-Material.pdf>

<https://www.iaisweb.org/uploads/2022/01/210525-Application-Paper-on-the-Supervision-of-Climate-related-Risks-in-the-Insurance-Sector.pdf>

—○○○—

Ky konsultim i tretë mbi rrezikun klimatik në sektorin e sigurimeve përfshin ndryshime të propozuara në disa nga parimet ICP dhe materialet mbështetëse për të pasqyruar rrezikun klimatik. Ai mbulon çështjet që lidhen me qeverisjen e korporatës, menaxhimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme, vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të aftësisë paguese, aktivitetet e investimit të siguriesve dhe kuadrin e menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjeve të siguriesve. Ndryshimet e propozuara në materiale pasqyrohen në dokumentet e mëposhtme:

- Materiali udhëzues për ICP përfshin shtesa të propozuara për të ndihmuar mbikëqyrësit në shqyrtimin e aspekteve të lidhura me klimën në ICP 15 (Investimet) dhe ICP 16 (Menaxhimi i rrezikut të ndërmarrjes për qëllime të aftësisë paguese).
- Materiali mbështetës përfshin gjuhën e draftit në formën e materialit të letrës së aplikimit. Ai përfshin:
 - Përditësimet e materialit ekzistues nga Dokumenti i Aplikimit 2021 mbi mbikëqyrjen e rreziqeve të lidhura me klimën në sektorin e sigurimeve, lidhur me qeverisjen e korporatës, menaxhimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme (ICPs 7 dhe 8), investimet (ICP 15) dhe menaxhimin e rrezikut të ndërmarrjes për qëllimet e aftësisë paguese (ICP 16).
 - Materiali i ri për vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të aftësisë paguese (ICP 14).

Materiali udhëzues i ICP-së synon të lehtësojë kuptimin dhe zbatimin e ICP-ve (Deklaratat Parimore dhe Standardet e tij) duke përfshirë rekomandime, sqarime dhe shembuj. Dokumentet e aplikimit ofrojnë këshilla të mëtejshme, ilustrime, rekomandime ose shembuj të praktikës së mirë për mbikëqyrësit në zbatimin e ICP-ve. Asnjë prej këtyre materialeve nuk përfaqëson ndonjë kërkesë të re, pasi ICP-të janë shkruar për të adresuar shumëllojshmërinë e gjerë të rreziqeve që lidhen me sigurimin, duke përfshirë rreziqet e lidhura me klimën.

Komentet duhet të bëhen deri më date 19 qershor 2024

BOSNJË-HERCEGOVINA

www.xprimm.com

Sikurse raporton SeeNews, duke iu referuar të dhënave zyrtare nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, vëllimi i primeve të shkruara bruto të shoqërive të sigurimeve që veprojnë në Federatë në periudhën janar-shkurt 2024, u rrit 14.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 118.2 milionë BAM ose 60.4 milionë euro.

Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 20% dhe arritën në 96 milionë BAM në dy muajt e parë të vitit 2024. Ndërsa sigurimet e Jetës ranë me 3.3% duke arritur në 22.1 milionë BAM.

Në tregun e sigurimeve në vend, në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës, në fund të shkurtit 2024, vepronin 19 kompani sigurimesh.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë për vitin 2023, tregu i sigurimeve në vend, në fund të vitit të kaluar arriti në rreth 1,508 miliardë HUF ose rreth 3.94 miliardë euro, duke shënuar kështu një rritje me 5.65% në krahasim me një vit më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ul me 6.28% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 571 miliardë HUF ose rreth 1.49 miliardë euro. Ndërsa Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 14.53% duke arritur në 938 miliardë HUF ose 2.45 miliardë euro. Në tregun hungarez të sigurimeve, sigurimet e Jetës zënë 37.84% dhe sigurimet e Jo-Jetës zënë 62.16% të totalit të primeve të shkruara bruto.

Për sa i përket dëmeve, vlera e dëmeve të paguara gjithsej u ul me 2.36% krahasuar me vitin e kaluar duke arritur në 786 miliardë HUF ose 2.05 miliardë euro. Ndikimin në këtë tregues e kishte rënia e dëmeve të paguara në sigurimet e Jetës, ndërsa për sigurimet e Jo-Jetës vlera e dëmeve të paguara u rrit me 10% krahasuar me një vit më parë.

Në fund të vitit 2023, numri total i kontratave të sigurimit u rrit me 1.1% krahasuar me një vit më parë, duke reflektuar një rritje prej rreth 162,000 të numrit të kontratave të reja. Ndikimin kryesor në rritje e kanë kontratat e sigurimit të Jo-Jetës të cilat u rritën me 1.3%, ndërsa numri i kontratave të sigurimit të Jetës pësoi një rënie prej 0.1%. Si rezultat, numri i përgjithshëm i kontratave të sigurimit kaloi 14.97 milionë në fund të tremujorit të katërt të vitit 2023.

Në treg veprojnë 22 shoqëri sigurimi, ku 4 shoqëri janë sigurues të Jetës, 9 sigurues të Jo-Jetës dhe 9 sigurues të përbërë Jetë dhe Jo-Jetë.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tregut për fundin e vitit 2023, të publikuara nga Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, HAIC, tregu i sigurimeve në vend arriti në 5.26 miliardë euro në fund të 2023, duke shënuar një rritje me 8.89% krahasuar me një vit më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto, për sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 12.10% krahasuar me vitin 2023, ndërsa primet e shkruara bruto të sigurimet e Jetës, u rritën me rreth 5.70% krahasuar me një vit më parë.

Në sigurimet e Jo-Jetës, të gjitha nënklasat kryesore të biznesit shënuan norma pozitive rritjeje, ndërsa në sigurimet e Jetës, produktet tradicionale patën ecuri negative me rënie prej 5.9%.

MBRETËRIA E BASHKUAR

www.xprimm.com

Analiza nga siguroesi më i madh i shtëpive në Mbretërinë e Bashkuar, Aviva, zbulon se një në trembëdhjetë ose rreth 8% e shtëpive të reja të ndërtuara në Angli, në dhjetë vitet e fundit, janë në një zonë përmbytjeje.

Që nga viti 2013/14, rreth 1,355,330 shtëpi të reja janë përfunduar në Angli, dhe rreth me 8% e tyre, pra 109,017 shtëpi të ndërtuara janë në zonën kombëtare të përmbytjeje. Disa nga këto prona mbrohen nga sistemet e mbrojtjes nga përmbytjet, por disa zona mund të mos e kenë mbrojtje. Ky numër përjashton shifrat për vitet 2022/23 të cilat nuk janë ende të disponueshme.

Për më tepër, hulumtimi i porositur nga Aviva midis banorëve të shtëpive të ndërtuara në pesë vitet e fundit zbulon se rreth 59% e tyre besojnë se shtëpia e tyre është në rrezik nga përmbytjet, krahasuar me 41% të banorëve të shtëpive të ndërtuara para vitit 2018.

Duket se shqetësimet klimatike shtrihen edhe përtej përmbytjeje. Pothuajse dy të tretat, pra rreth 61% e banorëve të shtëpive të reja janë të shqetësuar për ndikimin e nxehtësisë në shtëpinë e tyre, krahasuar me 46% të banorëve të shtëpive të ndërtuara para vitit 2018. Stuhitë janë gjithashtu një shqetësim, i përmendur nga 62% e banorëve të ndërtesave të reja nga 51% e banorëve të shtëpive të ndërtuara para 2018.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Siç tregojnë të dhënat e Agjencisë Sllovene të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AZN), ndërmjet viteve 1980 dhe 2020, humbjet ekonomike të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Slloveni arritën në 3.8 miliardë euro. Vetëm 43% e këtyre humbjeve ishin të siguruar, që korrespondon me një shumë prej 1.6 miliardë euro, shifra që tregojnë një boshllëk të konsiderueshëm në mbulimin me sigurime.

Sipas të dhënave të EIOPA, prevalenca e sigurimit nga përmbytjet në Slloveni është nën 25%. Sipas AZN, përballueshmëria mbetet një sfidë, pasi midis 25% dhe 50% e popullsisë nuk mund të përballojë sigurimin nga përmbytjet. “Ky hendek u bë veçanërisht i dukshëm vitin e kaluar gjatë fatkeqësive natyrore në shkallë të gjerë. Mbulimi me sigurim rezultoi i pamjaftueshëm, duke mbuluar vetëm rreth 16% të vlerës së dëmit ekonomik. Këto rrethana tregojnë nevojën urgjente për një strategji për të rritur përhapjen dhe përballueshmërinë e sigurimeve në Slloveni”, thuhet në një artikull të botuar në faqen e internetit të AZN.

Në situatën aktuale sigurimi është edhe më i rëndësishëm duke pasur parasysh se viti 2023 u shënuar si viti më i ngrohtë në 176 vitet e fundit, sipas Administratës Kombëtare të Vlerësimit dhe Klimës. Temperatura mesatare u rrit me 1.18°C krahasuar me shekullin XX dhe tejkaloi mesataren para-industriale me 1.35°C. Kjo ngrohje ka çuar në një rritje të ngjarjeve ekstreme të motit në mbarë botën, duke treguar një nevojë urgjente për zgjidhje efektive, për të ashtuquajturin sigurim NatCat.

Për siguresit sllovenë, viti 2023 kishte rekord të larta NatCat. Në përgjithësi, vlera e dëmeve të shkruara bruto arriti në 2,256 milionë euro, që është 35.3% më shumë se në 2022, kur kërkesat për pagimin e dëmeve arritën në 1,667 milionë euro. Nga kjo rritje me mbi gjysmë miliardë e shpenzimeve për dëme, peshën më të madhe e zënë klasat e sigurimit të pronës, me dëme të paguara që u rritën me 213 milionë euro, kryesisht si pasojë e stuhive të përsëritura të vitit të kaluar me breshër dhe përmbytjet në gusht.

Sigurimi duhet të marrë rolin e promovuesit të stabilitetit, duke siguruar një mbulim kyç për individët, kompanitë dhe shoqërinë ndaj humbjeve të rënda financiare dhe të përshpejtojë proceset e rikuperimit. Sigurimi gjithashtu promovon planifikimin dhe investimet ekonomike afatgjatë dhe kontribuon në stabilitetin e përgjithshëm rajonal, veçanërisht në zonat e ndjeshme ndaj rreziqeve klimatike.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al